

№ 1226 të datës 30 të Ligjit për Institucionet (Gazeta zyrtare...)  
drejtues i institucionit publik...  
Maqedonisë së Veriut në...  
i institucionit publik "Qendra...  
Maqedonisë së Veriut.  
Tekst i pastruar i Statutit të...  
Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut,  
10.06.2019, Vendi i shtetit

Јавна установа  
Institucioni publik  
**ДЕТСКИ КУЛТУРЕН ЦЕНТАР КАРПОШ**  
**QENDRA KULTURORE PËR FËMIJË KARPOSH**  
Скопје, Република Северна Македонија  
Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut

Број/numër 01-169/2  
Дата/дата 29.03.2023



**STATUTI**  
**I**  
**IP. QENDRA KULTURORE PËR FËMIJË –**  
**KARPOSH**

SHKUP, mars 2023

Në bazë të nenit 32 të Ligjit për institucionet (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 32/05), Këshilli drejtues i Institucionit publik "Qendra kulturore për fëmijë - Karposh" - Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut në seancën e mbajtur më 29.03.2023, përcaktoi tekstin e pastruar të Institucionit publik "Qendra kulturore për fëmijë - Karposh" - Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut.

Teksti i pastruar i Statutit të Institucionit publik "Qendra kulturore për fëmijë - Karposh" - Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut përfshin: Statutin nr. 01-433 të datës 10.06.2019, Vendimin statusor nr. 02 – 554/3 të datës 17.10.2022.

## **STATUTI**

I

Institucionit publik "Qendra Kulturore për fëmijë - Karposh" - Shkup,  
Republika e Maqedonisë së Veriut  
( tekst i pastruar)

### **I. Dispozita të përgjithshme**

#### **Neni 1**

Me Statutin e Institucionit publik „Qendra kulturore për fëmijë-Karposh” - Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm: Institucioni), konkretisht përcaktohen organizimi dhe mënyra e kryerjes së veprimtarisë, emërtimi, selia, menaxhimi, drejtimi, kontrolli, të drejtat dhe detyrimet e përfituesve të shërbimit publik, procedura për sjelljen, ndryshimin dhe plotësimin e Statutit dhe akteve të tjera të Institucionit, si dhe çështje të tjera me rëndësi për kryerjen e veprimtarisë dhe punës së Institucionit.

#### **Neni 2**

Themelues i Institucionit publik „Qendra kulturore për fëmijë - Karposh” - Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut, është Qyteti i Shkupit, në përputhje me Vendimin për marrjen e të drejtave themeluese të organizatave nga fusha e kulturës nr. 09-214/1 të datës 30.01.2004 (“Lajmëtari zyrtar i Qytetit të Shkupit” nr. 1/04), të sjellë nga Këshilli i Qytetit të Shkupit dhe Kontratën për bartjen e sendeve të paluajtshme, pajisjeve, të punësuarve dhe mjeteve të tjera për punë nga Republika e Maqedonisë te Qyteti i Shkupit, të nënshkruar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Qytetit të Shkupit, të regjistruar në Ministrinë e kulturës dhe Qytetin e Shkupit nën nr. 02-5139/1 më datën 19.08.2005 dhe te Qyteti i Shkupit nën nr. 08-2308/1 më datën 19.08.2005.

#### **Neni 3**

Në punën e Institucionit, gjuhë zyrtare janë gjuha maqedonase dhe alfabeti cirilik, dhe gjuha shqipe dhe alfabeti i saj, si gjuhë dhe alfabet, që e përdorin qytetarët si anëtarë të komunitetit i cili merr pjesë me mbi 20% në numrin e përgjithshëm të banorëve të Qytetit të Shkupit.

## II. Emërtimi dhe selia

### Neni 4

Emërtimi i Institucionit është:

- Јавна установа „ДЕТСКИ КУЛТУРЕН ЦЕНТАР КАРПОШ“ - Скопје, Република Северна Македонија;
- Institucioni publik “QENDRA KULTURORE PËR FËMIJË KARPOSH” - Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut.

Emërtimi i shkurtuar i Institucionit është:

- ЈУ „ДЕТСКИ КУЛТУРЕН ЦЕНТАР КАРПОШ“ - Скопје;
- IP – “QENDRA KULTURORE PËR FËMIJË KARPOSH” - Shkup.

Selia e Institucionit është në Shkup, në bul. „Ilindenska“ nr. 53.

## III. Vula dhe vula katrore

### Neni 5

Institucioni ka vulën dhe vulën katrore.

Vula ka formë rrethore me diametër 40 mm, në të cilën në pjesën e sipërme është shkruar teksti: Јавна установа „ДЕТСКИ КУЛТУРЕН ЦЕНТАР КАРПОШ“ - Скопје, Република Северна Македонија, ndërsa në pjesën e poshtme është shkruar teksti: Institucioni publik “QENDRA KULTURORE PËR FËMIJË KARPOSH” - Shkup, “Republika e Maqedonisë së Veriut”.

Në qendër të vulës është stema e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Vula katrore ka formë drejtkëndëshi me dimensione 65 x 40 mm dhe në të është shkruar teksti:

Јавна установа  
Institucioni publik  
ДЕТСКИ КУЛТУРЕН ЦЕНТАР КАРПОШ  
“QENDRA KULTURORE PËR FËMIJË KARPOSH”  
Скопје, Република Северна Македонија.  
Shkup, “Republika e Maqedonisë së Veriut”.  
Број/numër \_\_\_\_\_  
Дата/data \_\_\_\_\_ ”

### Neni 6

Mënyra e përdorimit dhe ruajtja e vulës dhe vulës katrore të Institucionit rregullohet me vendim të drejtorit në përputhje me Ligjin.

## IV. Veprimtaria e Institucionit

### Neni 7

Institucioni kryen veprimtari nga fusha e kulturës si veprimtari me interes publik me qëllim jofitimprurës.

### Neni 8

Në qarkullimin juridik dhe në marrëdhëniet me persona të tretë Institucioni vepron në emër të vet dhe për llogari të vet, vetëm në suazat e veprimtarisë e cila është shkruar në Regjistrin qendror.

## **Neni 9**

Veprimtari themelore e Institucionit është: kryerja e veprimtarisë jashtëshkollore, edukativo-arsimore, sociale, argëtuese dhe rekreative në formën e aktiviteteve të rregullta, manifestimeve, kremtimeve dhe shënimeve nën shifrën 90.04 – veprimtari e objekteve për veprimtari kulturore.

Me qëllim realizimin e veprimtarisë së vet Institucioni kryen aktivitetet e mëposhtme:

- integron fëmijët nga mosha parashkollore deri në moshën 18 vjeç në aktivitetet e Qendrës, dhe nëpërmjet saj i integron në jetën shoqërore të qytetit dhe vendit, përkatësisht, mundëson integrimin e adaptuar didaktik të fëmijëve në jetën kulturore-shoqërore;

- orienton zhvillimin individual të fëmijëve drejt realizimit të stabilitetit dhe sigurisë shoqërore afatgjate, nëpërmjet aktiviteteve kreative, pedagogjike, argëtuese dhe rekreative;

- siguron anëtarësi masive të fëmijëve dhe përmbajtje të ndryshme që ofron ai dhe siguron gatishmëri të vazhdueshme për plotësimin dhe ndryshimin e tyre në varësi të nevojave dhe interesave të fëmijëve;

- mundëson qasje të shpejtë të fëmijëve në të gjitha sferat interesante për ta, dhe hap mundësi për pjesëmarrje aktive të të gjitha strukturave shoqërore në të;

- miraton dhe zhvillon përmbajtje dhe forma bashkëkohore edukative-pedagogjike nëpërmjet kontaktit me organizata të njëjta ose të ngjashme në vend dhe jashtë tij dhe nëpërmjet ndjekjes së trendëve ekzistues bashkëkohor në fushat interesante;

- përcakton vlerat në shoqërinë civile nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencave me organizata me karakter të njëjtë ose të ngjashëm, OJQ-të dhe subjekte ekonomike dhe i zbaton në mënyrë didaktike në punën e vet;

- organizon klube, seksione, ekspozita, manifestime, këshillime, seminare etj;

- bashkëpunon me shkollat dhe punonjësit e arsimit dhe me të gjitha lidhjet, shoqatat, organizatat dhe institucionet në vend dhe jashtë tij veprimtaria e të cilave është edukimi jashtëshkollor dhe arsimimin e fëmijëve;

- kujdeset për përsosmërinë dhe trajnimin plotësues të kuadrove profesionalë;

- kryen dhe punë të tjera që i janë caktuar në përputhje me ligjin, me këtë Statut dhe me akte të tjera të përgjithshme të Qendrës.

## **Neni 10**

Përveç veprimtarisë themelore, në pajtim me themeluesin, Institucioni mund të kryejë edhe veprimtari plotësuese.

## **Neni 11**

Institucioni sjell program zhvillues me të cilin përcaktohen qëllimet dhe drejtimit e zhvillimit shumëvjeçar të veprimtarisë.

### **Neni 12**

Në realizimin e veprimtarisë, në përputhje me programin, Institucioni bashkëpunon me organizata të tjera, nëpërmjet realizimit të aktiviteteve të caktuara, shkëmbimit të eksperiencave dhe në mënyra të tjera.

## **V. Njësi organizative**

### **Neni 13**

Institucioni organizon procesin e punës në mënyrë të tillë, me të cilën siguron efikasitet dhe cilësi në punë.

Veprimtaria programore e Institucionit realizohet nëpërmjet këtyre njësive organizative të brendshme:

- Seksioni i muzikës;
- Seksioni humanitar;
- Seksioni i dramës
- Seksioni i arteve pamore;
- Seksioni për marrëdhënie ndërkombëtare;
- Seksioni i sportit.

Njësitë organizative të brendshme nuk kanë cilësinë e personit juridik.

### **Neni 14**

Organizimi i punës së Institucionit rregullohet me aktin për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës.

### **Neni 15**

Formimi i njësive organizative, si dhe bashkimi, mbyllja ose ndarja e atyre ekzistuese, kryhet me vendim të Këshillit drejtues të Institucionit.

## **VI. Përfaqësimi dhe paraqitja**

### **Neni 16**

Institucionin e përfaqëson dhe paraqet drejtori i Institucionit.

### **Neni 17**

Drejtori mundet me autorizim me shkrim, të autorizojë person tjetër ta përfaqësojë dhe paraqesë Institucionin.

Përmbajtjen dhe volumin e autorizimeve nga paragrafi 1 i këtij neni e përcakton drejtori i Institucionit.

### **Neni 18**

Përfaqësuesi është i autorizuar në emër të Institucionit, dhe në suazat e kompetencave të tij, të kryejë veprime të shprehura qartë në autorizim.

## **VII. Të drejtat dhe detyrimet e përfituesve**

### **Neni 19**

Secili ka të drejtë, nën kushte të njëjta, të ketë qasje në shërbimet e Institucionit.

Fëmijët, nxënësit dhe studentët, si dhe personat me nevoja të posaçme paguajnë shërbime me çmime më të ulëta, ose janë të liruar nga pagimi. Këshilli drejtues me vendim të veçantë rregullon kriteret për dhënien e uljeve.

## **VIII. Organe të Institucionit**

### **Neni 20**

Organe të Institucionit janë:

1. Këshilli drejtues;
2. Drejtori;
3. Këshilli mbikëqyrës
4. Kolegjiumi profesional

### **1. Këshilli drejtues**

### **Neni 21**

Këshilli drejtues ka kryetar, ai cakton seancat dhe nënshkruan aktet e Këshillit drejtues dhe kryen punë të tjera në përputhje me Statutin.

### **Neni 22**

Organi Drejtues i Institucionit është Këshilli Drejtues.

Këshilli Drejtues i Institucionit ka 5 anëtarë, tre prej të cilëve janë përfaqësues nga individë të shquar të fushës së kulturës dhe dy përfaqësues profesionistë dhe kompetentë nga radhët e punonjësve të Institucionit.

### **Neni 22-a**

Anëtar i Këshillit Drejtues të Institucionit mund të emërohet person i cili plotëson kushtet e mëposhtme:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- të ketë fituar të paktën 240 kredi ECTS ose të ketë përfunduar arsimin e shkallës VII/1 në fushën përkatëse;
- në momentin e emërimit me vendim gjyqësor të formës së prerë nuk është shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtjeje, ndalim në ushtrimin e profesionit, veprimtarisë apo detyrës.

Përveç kushteve të përgjithshme nga paragrafi 1 i këtij neni, anëtarët e Këshillit Drejtues në Institucion të zgjedhur nga Këshilli i Qytetit të Shkupit duhet të kenë edhe përvojë adekuate pune si vijon:

- të paktën një anëtar i Këshillit Drejtues duhet të ketë më së paku pesë vjet përvojë pune në fushën e kulturës;
- të paktën një anëtar i Këshillit Drejtues duhet të ketë më së paku tre vjet përvojë pune në fushën e financave, dhe

- të paktën një anëtar i Këshillit Drejtues duhet të ketë më së paku tre vjet përvojë pune në fushën e çështjeve juridike.

### **Neni 22-b**

Këshilli Drejtues ka kryetar të cilin e emëron dhe shkarkon Këshilli i Qytetit të Shkupit.

Kryetari dhe anëtarët e Këshillit Drejtues të Institucionit emërohen në bazë të parimit të profesionalizmit dhe kompetencës, për një periudhë katërvjeçare dhe mund të riemërohen.

### **Neni 22-v**

Për emërimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institucionit, Qyteti i Shkupit shpall thirrje publike për aplikim nga personat e interesuar, tre muaj para skadimit të mandatit të anëtarëve ekzistues.

Thirrja publike shpallet në ueb-faqen e Qytetit të Shkupit dhe në ueb-faqen e Institucionit për të cilin është shpallur thirrja publike.“

### **Neni 22-g**

Anëtarët e Këshillit Drejtues të Institucionit kanë të drejtën e kompensimit mujor për punën e tyre, në bazë të pjesëmarrjes në seancat e Këshillit Drejtues të Institucionit.

Kompensimi i përgjithshëm mujor i kryetarit dhe i anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institucionit individualisht, nuk mund të kalojë gjysmën e pagës mesatare neto të punonjësve të Institucionit të paguar në vitin paraardhës.

Vlera e kompensimit mujor për kryetarin dhe anëtarët e Këshillit Drejtues të Institucionit caktohet me vendim të Këshillit të Qytetit të Shkupit

*- kompetencat e Këshillit drejtues*

### **Neni 23**

Këshilli i drejtues i Institucionit:

1. Sjell Statutin e Institucionit;
2. Përcakton politikat dhe parimet e zhvillimit dhe punën e Institucionit;
3. Miraton llogarinë vjetore dhe raportin për punën e Institucionit, me propozim të drejtorit;
4. Jep pëlqim për aktet e sistematizimit dhe organizimit të vendeve të punës dhe aktit për alokimin e pagave
5. Sjell programin vjetor për punën e Institucionit, me propozim të drejtorit;
6. Miraton planin financiar, llogarinë vjetore të Institucionit dhe dokumente të tjera financiare, në përputhje me dispozitat për punën materiale dhe financiare;
7. Vendos në shkallë të dytë për aktvendimet që i sjell drejtori;
8. Formon organe pune të përhershme dhe të përkohshme;
9. Miraton raport për regjistrimin e mjeteve themelore;
10. Vendos për çregjistrimin e kërkesave dhe detyrimeve të Institucionit në pajtim me Këshillin e Qytetit të Shkupit;
11. Vendos për çmimet e shërbimeve në pajtim me Këshillin e Qytetit të Shkupit;
12. Sjell masa për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit jetësor;
13. Kryen dhe punë të tjera të përcaktuara me Ligj dhe Statut.
14. Sjell Rregulloren për punë të Këshillit drejtues.

## **Neni 24**

Institucioni dorëzon për miratim pranë Qytetit të Shkupit programin vjetor për punë, raportin për punë dhe planin financiar.

### **2. Drejtori**

## **Neni 25**

Drejtori është organ drejtues i Institucionit.

Drejtorin e Institucionit e zgjedh dhe shkarkon Kryetari i Qytetit të Shkupit (në tekstin e mëtejshëm: Kryetari i Qytetit).

Drejtori zgjidhet me mandat 4 vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

- *kompetenca të Drejtorit*

## **Neni 26**

Drejtori:

1. Drejton punën e Institucionit;
2. Përfaqëson dhe paraqet Institucionin;
3. Përgjigjet për punën materialo-financiare dhe për ligjshmërinë;
4. I propozon Këshillit drejtues program për punën e Institucionit;
5. Propozon sjelljen e akteve nga sfera e veprimit e Institucionit;
6. Sjell akte për sistematizimin dhe organizimin e vendeve të punës dhe rregulloren për alokimin e pagave
7. Siguron realizimin e vendimeve dhe konkluzioneve të Këshillit drejtues;
8. Sjell akte të cilat nuk janë nën kompetencat e Këshillit drejtues, dhe që kanë të bëjnë me drejtimin e Institucionit;
9. I propozon Këshillit drejtues raport vjetor për punën e Institucionit;
10. Jep urdhëresa për punën financiare të Institucionit;
11. Vendos për nevojën për themelimin e marrëdhënieve të punës, sistematizimin e punëtorëve dhe ndërprerjen e marrëdhënieve të punës;
12. Vendos për fillimin dhe përfundimin e orarit të punës dhe pushimit gjatë kohës së orarit të punës;
13. Organizon informimin e punëtorëve;
14. Siguron masa për mbrojtje gjatë punës;
15. Formon kolegjiun dhe emëron persona përgjegjës në sektorë; dhe
16. Shqyrton sugjerime dhe vërejtje të sindikatës në realizimin e të drejtave të punëtorëve, gjendjes së tyre materiale dhe kushteve për punë.

- *procedura për zgjedhjen e drejtorit*

## **Neni 27**

Për drejtor mund të zgjidhet person i cili plotëson kushtet e mëposhtme:

- 1) është shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- 2) në momentin e zgjedhjes me vendim gjyqësor të formës së prerë nuk i është shqiptuar dënim ose kundërvajtje, ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë apo detyrës;
- 3) ka fituar të paktën 240 kredi sipas EKTC ose ka përfunduar shkallën VII/1 të arsimit të lartë të përcaktuar me statutin e Institucionit;
- 4) ka minimum 5 vjet përvojë pune në fushën e kulturës ose projekte në fushën e kulturës mbi bazën e kontratave për punë;
- 5) ka një nga certifikatat e mëposhtme ndërkombëtare të njohura ose vërtetim për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se 5 vjet:



- TOEFEL IBT – më së paku 74 pikë,
- IELTS më së paku 6 pikë,
- ILEC ( Cambridge English: Legal) - më së paku nivel B2
- FCE ( Cambridge English: First) - të përfunduar,
- BULATS – më së paku 60 pikë ose,
- APTIS – më së paku nivel B2.

### **Neni 28**

Drejtori i Institucionit zgjidhet me anë të shpalljes publike që publikohet nëpërmjet mjeteve për informim publik, më së voni tre muaj para skadimit të mandatit të drejtorit të mëparshëm.

Shpalljen publike e publikon Kryetari i Qytetit.

Kandidatët dorëzojnë dokumentacionin e nevojshëm në përputhje me shpalljen publike pranë Këshillit drejtues të Institucionit.

Kandidatët për drejtor në mënyrë të detyrueshme dorëzojnë Propozim-programin e vet për zhvillimin e Institucionit.

### **Neni 29**

Dokumentet e arritura i shqyrton komisioni tre anëtarësh i formuar nga Këshilli drejtues i Institucionit.

Komisioni është i obliguar në një afat kohor prej pesë ditësh nga përfundimi i shpalljes publike t'i shqyrtojë dokumentet e dorëzuara.

Komisioni i dorëzon propozim për kandidatët Kryetarit të Qytetit.

Kryetari i Qytetit, në një afat kohor prej 15 ditësh nga dita e marrjes së propozimit kryen zgjedhjen e drejtorit.

### **Neni 30**

Kandidatët të cilët nuk janë zgjedhur kanë të drejtë ankese në lidhje me realizimin e procedurës për zgjedhjen e drejtorit të Institucionit, në një afat kohor prej tetë ditësh nga pranimi i vendimit të Kryetarit të Qytetit. Ankesa dorëzohet pranë Komisionit të shkallës së dytë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut kompetente për zgjedhjen e çështjeve nga fusha e marrëdhënieve të punës.

Kundër vendimit të komisionit nga paragrafi i mëparshëm, kandidati ka të drejtë të iniciojë procedurë para gjykatës kompetente.

*- kryerësi i detyrës drejtor*

### **Neni 31**

Në rastin kur nuk është zgjedhur drejtor ose mandati i është ndërprerë para kohe, Kryetari i Qytetit menjëherë emëron kryerës të detyrës drejtor, pa shpallje publike, nga radhët e të punësuarve.

Kryerësi i detyrës drejtor emërohet deri në zgjedhjen e drejtorit të Institucionit, dhe më së shumti për një periudhë prej gjashtë muajsh.

Kryerësi i detyrës drejtor i ka të gjitha të drejtat dhe detyrimet e drejtorit të Institucionit.

*- ndërprerja e mandatit*

### **Neni 32**

Drejtori i Institucionit mund të shkarkohet edhe para skadimit të mandatit për të cilin është zgjedhur.

Drejtori mund të shkarkohet:

1. Me kërkesën e tij personale;
2. Nëse nuk realizon Programin për punë të Institucionit;
3. Nëse për faj të tij i është shkaktuar dëm Institucionit dhe
4. Nëse nuk punon në përputhje me Ligjin, Statutin dhe në raste të tjera të parashikuara me Ligj.

### **3. Këshilli mbikëqyrës**

#### **Neni 33**

Këshilli Mbikëqyrës është organi për kontrollin e punës materialo- financiare të Institucionit.

Këshilli Mbikëqyrës i Institucionit përbëhet nga tre anëtarë të cilët emërohen, përkatësisht shkarkohen nga Këshilli i Qytetit të Shkupit.

#### **Neni 33-a**

Anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës të Institucionit emërohen personat që nuk kanë lidhur marrëdhënie pune me Institucionin, kanë arsim të lartë dhe posedojnë njohuri dhe përvojë veçanërisht nga fusha e kulturës.

#### **Neni 33-b**

Anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Institucionit mund të emërohet person i cili plotëson kushtet e mëposhtme:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- të ketë fituar të paktën 240 kredi ECTS ose të ketë përfunduar arsimin e shkallës VII/1 në fushën përkatëse;
- në momentin e emërimit me vendim gjyqësor të formës së prerë nuk është
- shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtjeje, ndalim në ushtrimin e profesionit, veprimtarisë apo detyrës

Përveç kushteve të përgjithshme nga paragrafi 1 i këtij neni, anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës në Institucion të zgjedhur nga Këshilli i Qytetit të Shkupit duhet të kenë edhe përvojë adekuate pune si vijon:

- një anëtar i Këshillit Drejtues duhet të ketë më së paku pesë vjet përvojë pune në fushën e financave;
- një anëtar i Këshillit Drejtues duhet të ketë më së paku pesë vjet përvojë pune në fushën e çështjeve juridike, dhe
- një anëtar i Këshillit Drejtues duhet të ketë më së paku pesë vjet përvojë pune në fushën e kulturës.

Në procedurën e emërimit të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës në Institucion, zbatohen në mënyrë adekuate dispozitat e nenit 22-v të këtij Statuti, të cilat i referohen procedurës së emërimit të anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institucionit.

### **Neni 33-v**

Këshilli Mbikëqyrës ka kryetar të cilin e emëron dhe shkarkon Këshilli i Qytetit të Shkupit.

Kryetari dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të Institucionit emërohen për një periudhë katër vjeçare dhe mund të riemërohen.

### **Neni 33-g**

Kryetari dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të Institucionit, për çdo seancë të Këshillit Mbikëqyrës në të cilën kanë marrë pjesë, kanë të drejtën e kompensimit në vlerën e një të tretës së pagës mesatare neto të punonjësve të Institucionit të paguar në vitin paraardhës.

Vlera e kompensimit nga paragrafi 1 i këtij neni caktohet me vendim të Këshillit të Qytetit të Shkupit.

## ***4. Kolegjiumi profesional***

### **Neni 34**

Në Institucion formohet kolegjiumi profesional.

Kolegjiumi profesional përbëhet nga redaktorët dhe Drejtori i Institucionit.

Në varësi të temës për diskutim mund të thërriten edhe të punësuar të tjerë dhe persona të jashtëm.

Kolegjiumi profesional shqyrton programet dhe raportet për punë të Institucionit, propozon forma të reja pune dhe kujdeset për cilësinë e programit.

## **IX. Të drejta nga marrëdhëniet e punës**

### **Neni 35**

Ligjet dhe dispozitat për marrëdhëniet e punës, për sigurimin shëndetësor, pensional dhe invalidor, Kontrata kolektive për kulturë dhe aktet e tjera ligjore zbatohen në mënyrë adekuate për punonjësit e Institucionit.

Të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhëniet e punës punëtorët i realizojnë si në një organizatë të vetme.

Marrëdhëniet e punës, përkatësisht puna profesionale bazohet në lidhjen e kontratës për punë ndërmjet punëtorit dhe drejtorit të Institucionit.

Drejtori kryen sistematizimin e punëtorëve në përputhje me aktin për sistematizim.

Puna artistike, përkatësisht profesionale në Institucion mund të kryhet edhe me lidhjen e kontratës autoriale, përkatësisht realizuese ose kontrate tjetër të drejtorit me artistin, artistin e pavarur ose me një person tjetër fizik.

### **Neni 36**

Gjatë punësimit në Institucion, në mënyrë të detyrueshme zbatohen kriteret dhe parimet me të cilat sigurohet përfaqësimi adekuat dhe i drejtë i qytetarëve të cilët u përkasin të gjitha komuniteteve.

## **X. Prona, financimi dhe planifikimi**

### **Neni 37**

Këshilli mbikëqyrës i Institucionit, me propozim të drejtorit, miraton planin financiar të Institucionit.

Drejtori i Institucionit është përgjegjës për përgatitjen në kohë dhe zbatimin e planit financiar të Institucionit.

### **Neni 38**

Institucioni disponon dhe shfrytëzon pronën dhe mjetet themelore në përputhje me Ligjin, Statutin dhe aktet e tjera të përgjithshme të Institucionit.

Prona dhe mjetet themelore nga paragrafi 1 i këtij neni janë në pronësi të Qytetit të Shkupit.

### **Neni 39**

Institucioni përgjigjet për ruajtjen e vlerës integrale të mjeteve themelore dhe është i detyruar:

- t'i përdorë dhe mirëmbajë sipas kushteve teknike;
- ta kompensojë pjesën e paçregjistruar të vlerës, nëse mjetet janë të amortizuara fizikisht ose janë çregjistruar para skadimit të afatit për çregjistrim.

### **Neni 40**

Mjetet themelore me të cilat menaxhon Institucioni mund të tjetërsohen nën kushte dhe në procedurë të përcaktuar me Ligj.

Për tjetërsimin e mjeteve themelore vendos Këshilli i Qyteti të Shkupit në përputhje me Ligjin.

### **Neni 41**

Institucioni të paktën një herë në vit kryen regjistrimin e mjeteve themelore me të cilat disponon dhe menaxhon.

## **XI. Procedura për sjelljen e statutit dhe akteve të tjera në Institucion**

### **Neni 42**

Statutin dhe aktet e tjera të përgjithshme i sjell Këshilli drejtues në seanca me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.

Dispozitat për sjelljen e Statutit zbatohen edhe në procedurën për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit.

### **Neni 43**

Këshilli i Qytetit të Shkupit jep pëlqim për Statutin e Institucionit.

## **XII. Dispozita kalimtare dhe përfundimtare**

### **Neni 44**

Institucioni publik „Qendra kulturore për fëmijë-Karposh” – Shkup është organizuar me Vendimin nr. 15-28418/27,12,73 dhe është regjistruar në Regjistrin e Gjykatës ekonomike të Qarkut – Shkup me fletë regjistrimi nr. 018-2235/1 më datën 15.05.1948.

Vendimet nga neni 2 paragrafi 1 janë konfirmuar me aktvendimin numër 07-5622 të sjellë nga Këshilli i komunës së qytetit të Shkupit më datën 28.02.1974 (Lajmëtari zyrtar i qytetit të Shkupit, numër 13/74).

### **Neni 45**

Me hyrjen në fuqi të këtij Statuti, shfuqizohet Statuti i Institucionit nga data 10.06.2019 dhe dispozitat e akteve të tjera të përgjithshme, që janë në kundërshtim me dispozitat e këtij Statuti.

### **Neni 46**

Ky Statut hyn në fuqi ditën e tetë, nga dita e shpalljes së tij në Tabelën e njoftimeve të Institucionit, dhe do të zbatohet pas marrjes së pëlqimit nga ana e Këshillit të Qytetit të Shkupit.

Shkup, 29.03.2023

